



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 22.06.2020

Ref.: 578/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016),

neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 80-të, të mbajtur më 01 Prill 2020, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Gjakovës " (Nr.2102/19H, datë 30.10.2019) për riakreditim / akreditim të programeve të studimit:
 - Mami, BSc, 180 ECTS
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS
 - Fizioterapi, BSc, 180 ECTS

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka parashtruar kërkesë (Nr.2102/19H, datë 30.10.2019) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim / akreditim të programeve të studimit: Mami BSc, 180 ECTS, Infermieri BSc, 180 ECTS, Fizioterapi BSc, 180 ECTS.

Programi Mami BSc, 180 ECTS

Universiteti i Gjakoves "Fehmi Agani" ka parashtruar kërkesë për zhvendosje të stafit akademik të paraparë për këtë program. Rrjedhimisht programi është prezantuar pa bartës.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Mbi këtë bazë, KShC mori vendim për refuzim të aplikacionit.

Për programin Infermieri, BSc, 180 ECTS,

Si bartës të këtij programi, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, ka paraparë këta persona: Ramush Bejiqi (PhD në Pediatri), Ilirjana Raça Bunjaku (PhD në kurset klinike), Qëndresa Qovanaj (MA në Menaxhment Shëndetësor), Besarta Pelaj (MA në Menaxhment Shëndetësor), Vanesa Tanushi (MA në Menaxhment Shëndetësor të Institucioneve dhe Shërbime), Arta Dalipi (MA në Menaxhim në Infermieri), Hateme Hoxha (Doktor i Mjekësisë), Bylbyl Kadrija (Doktor i Mjekësisë).

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc, Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”.* Përveç kushteve të cekura me sipër IAL-të duhet të kenë staf permanent nga fusha e programit të studimit, të paktën me gradën MA.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto te dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 01 prill 2020, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzojë aprovimin e aplikacioneve të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, sipas diapozitivit II të këtij vendimi.

Pas verifikimit të stafit akademik, KSHC erdhi në përfundim që nga bartësit e programit të prezantuar më lartë, vetëm Arta Dalipi është e fushës së programit të studimit, dhe ajo nuk është në marrëdhënie të rregullt pune me këtë Universitet.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore te sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4, dhe 5.3.11 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Infermieri, BSc, 180 ECTS.*

Për programin e studimit: Fizioterapi, Bachelor Profesional, 180 ECTS

Si bartës të këtij programi, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", ka paraparë këta persona: Arben Boshnjaku (MA në Fizioterapi), Idriz Berisha (PhD në Shkenca Mjekësore), Edita Çufaj Kadrija (MA në Edukim për Kujdesin Shëndetësor), Skender Ukaj (MA në Shkenca Mjekësore), Kushtrim Grezda (Doktor i Mjekësisë), Bajram Shyti (MSc në Fizioterapi).

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Gjithashtu sipas nenin 27, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018) *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse"*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Pas verifikimit të stafit akademik, KShC erdhi në përfundim që nga bartësit e programit të prezantuar më lartë, vetëm Arben Boshnjaku dhe Bajram Shyti janë të fushës së programit të studimit, dhe Bajram Shyti nuk është në marrëdhënie të rregullt pune me këtë Universitet.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4, dhe 5.3.11 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Fizioterapi, Bachelor Profesional, 180 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani"
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë